



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRI I TREGTISË DHE INDUSTRIJË	
Min. Org. Dok. Nr. Dok. Dat.	02
Min. Proq. Dok. Nr. Dok. Dat.	674
Min. Proq. Dok. Nr. Dok. Dat.	1
Prishtinë / 11	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Ministarsivo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry
Zyra e Sekretares së Përgjithshëm - Ured Generalnog Sekretara - Office of the Sekretary General

Prishtinë 09.11.2011
02 Ref. 114/11- 2011

Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në mbështetje të nenit 93 paragrafi 4, nenit 145 paragrafi 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 38 të Ligjit Nr. 03/L-189 Për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, në nenit 17 paragrafi 5 dhe paragrafi 6 të Rregullores Nr. 02/2011 Për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 5 paragrafi 5.4. pika (c) të Rregullores Nr. 2001/19 për Degën e Ekzekutivit, si dhe nënparagrafit 1.1 të nenit 8 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, merr:

VENDIM
PËR PEZULLIM

Ramadan Buzhala – Drejtor i Zyrës për Licencim dhe vëzhgim të derivateve të naftës, pezullohet nga detyra deri në shqyrtimin e rastit në komisionin disiplinor. Zyrta nuk duhet të vazhdojë të vijë në punë në ministri deri në zgjedhjen e rastit në komisionin disiplinor.

Arsyetim

Bazuar në nënparagrafin 1.2.1, të nenit 67 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nënparagrafi 1.1 të nenit 8 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, si dhe në bazë të raportimit mbi shkelje me anë të e-mail zyrtar nga Sekretarja e Përgjithshme me datë 08.11.2011, për shkak të dyshimit për nxjerrje të informatave të brendshme, si dhe dyshimit mbi procesin e dhënies së lejeve në import, proces ky i cili është në faze të shqyrtimit nga NJAB, nga të cekurat me lartë u mir vendim si në dispozitiv.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Sekretarja e Përgjithshme e MTI-së.

- Vendimi i dorëzohet:
- Zyrtari _____
- Komisionit Disiplinor
- Divizionit të personelit dhe
- Arkivit

Eljana NAKA
03.11.11
Sekretare e Përgjithshme e MTI-së
Prishtinë



1204	698
2	05.12.11

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Tergovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

Komisioni Disiplinor /Diciplinska Komisija/ Disciplinary Board

Komisioni Disiplinor bazuar në nenin 71 nënparagrafët 1.1, 1.2,1.3, nenin 66 nënparagrafi 3.1. të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, si dhe Rregulloren Nr 04/2011 për procedurat disiplinore në shërbimin civil, në Seancën dëgjimore të mbajtur me 07.12.2011. nxjerr këtë:

V E N D I M

Nëpunësi civil z. Ramadan Buzhala për shkak të shkeljes së rëndë të paraparë në Rregulloren Nr 04/2011 për procedurat disiplinore në shërbimin civil Neni 6 pika 1.10 shkelja e detyrave të punës që kanë pasoja për palën dhe organin e lartë shtetëror dhe pika 1.15 kryerja e aktiviteteve që bien ndesh me interesat e institucionit dhe organet e tjera shtetërore. Me ç'rast komisioni ka vendosë që z. Ramadan Buzhales të shqiptohet masa e parapare sipas nenit 8 pika 1.4 i Rregullores Nr 04/2011 për procedurat disiplinore në shërbimin civil:

Ndërprerja e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil nga komisioni disiplinor pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension

Me hyrjen e këtij vendimi në fuqi, shfuqizohet vendimi për pezullim nr. 671 i datës 09.11.2011.

A r s y e t i m

Vendimi është marre bazuar në shkresat e lëndës si dhe pas shqyrtimit të të gjitha provave veç e veç si dhe shqyrtimit të materialeve të pranura nga raporti i lëndës 2011/4, shkresës zyrtare të Sekretares së Përgjithshme, raportit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm në MTI me numër ref. 677 i datës 11.11.2011, të gjeturat nga inspektorati i tregut i MTI-se dhe poashtu materialet e dalura nga seanca dëgjimore mbajtur me datën 07.12.2011.

Vendimi hyn ne fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur ka te drejte ankese ne Komisionin për ankese pranë MTI-se ne afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit te Vendimit, ankesa dorëzohet përmes DAQ-se përkatësisht Divizionit te personelit.

Vendimi i dorëzohet:

z. Ramadan Buzhala

Sekretarit te Përgjithshëm te MTI-se
Personelit
Arkivit

Anëtarët e Komisionit Disiplinor

1. Irfan Lipovica - kryesues
2. Gazmend Mejzini - anëtar
3. Lebibe Haliti - anëtare



REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVËS

02

1586

03

06.04.2012



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVËS

05 04 2

SLAVISHA 59/2012

113

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A 02/37/2012

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje: Sabile Avdyli, kryetare, Bajram Zogiani dhe Irena S. Ahmedi - anëtarë të Kolegjit të Këshillit për shqyrtimin e ankesës nr. 02/37/2012, të datës 29.02.2012, të parashtruar nga z.Ramadan Buzhala, Banjë Komuna e Malishevës, në çështjen juridike – ndërprerje e marrëdhënies së punës – drejtor i Zyrës për licencim dhe vëzhgim të derivateve të naftës, duke vepruar në pajtim me nenin 10 parag.1 pika 1.1, nenin 12 parag.2 dhe 3 të Ligjit nr. 03/L-192 - për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 85, 86 dhe 129 paragrafi 129.3 i Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, nenit 14, paragrafi 2, të Rregullores nr. 02/2011, Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshill, në seancën jopublike, të mbajtur më 05.04.2012, merr këtë:

V E N D I M

I. Kthehet në rishqyrtim dhe vendosje Komisionit për zgjedhjen e kontesteve dhe të ankesave në Ministrinë e Tregëtisë dhe Industrisë, ankesa nr.14 e datës 04.01.2012, e parashtruar nga ankuesi Ramadan Buzhala.

II. OBLIGOHET, organi i punësimit-Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë, që në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, t'a rishqyrtojë ankesën e përmendur në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, duke respektuar rregullat dhe procedurat ligjore të arsyetohet Vendimi nr.367 i datës 03.02.2012, sipas nenit 85 dhe 86 të Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative.

A r s y e t i m

Ankuesi z. Ramadan Buzhala, Drejtor i Zyrës për Liqencim dhe Vëzhgim në Ministrinë e Tregëtisë dhe Industrisë, me Vendimin nr.698 të datës 09.12.2011 të komisionit Disiplinor i shqiptohet masa disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension. Ankuesi i pakënaqur me këtë vendim, paraqet ankesë nr.14 më datën 04.01.2012 në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe

T'i dorëzohet: Ankuesit, Ramadan Buzhala, Sekretarit/es të Përgjithëshem të Ministrisë së Tregëtisë dhe Industrisë , Menaxherit të Personelit dhe Dosjes së lëndës ankimore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda nr. 02 (37) 2012, më 05.04.2012.

Kryetare e Kolegjit



Ankesave në Ministrinë e Tregëtisë dhe Industrisë, i cili komision me Vendimin nr. 367 të datës 03.02.2012, ka lënë në fuqi Vendimin nr.698 të datës 09.12.2011 të Komisionit Disiplinorë të Ministrisë së Tregëtisë dhe Industrisë. Ankuesi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë me nr.02/37/2012 të datës 29.02.2012 në Këshillin e Pavarur mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore: për shkak të shkeljeve procedurale, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Kolegji i Këshillit kompetent për vendosjen e kësaj çështjeje, në bazë të dispozitës së nenit 10 parag. 1.1, neni 12 parag. 12.2 i Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe dispozitave ligjore në fuqi ka shqyrtuar të gjitha shkresat parashtruara të lëndës, ka vërtetuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, duke e obliguar Organin e Punësimit që ta ri-shqyrtojë ankesën e ankuesit të paraqitur në Komisionin për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave të organit të punësimit për këto arsye:

Dispozitivi i Vendimit nr. 367 të datës 03.02.2012 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Tregëtisë dhe Industrisë është i pa qartë, nuk është arsyetuar sipas nenit 85 paragrafi 85.1 i Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, ku thuhet: "Përveç rasteve kur ligji vetë parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte të cilat pjesërisht ose tërësisht: a) mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në ndonjë mënyrë tjetër të drejta dhe interesa ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime;", si dhe neni 86, parag. 1 dhe 86 parag 3 cili thotë se : "Arsyetimi duhet të formulohet qartë dhe të përfshijë shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Arsyetimi me të dhëna të paqarta, kontradiktore ose të pasakta, është i barasvlershëm me mungesën e arsyetimit."

Kolegji konkludon se vendimi nuk përmban elementet dhe informacionet e nevojshme të Aktit Administrativ siç është përcaktuar me nenin 84 të këtij Ligji. Kolegji i Këshillit konstaton se për këtë arsye duhet të kthehet në rishqyrtim dhe vendosje Komisionit për zgjedhjen e kontesteve dhe të ankesave në Ministrinë e tregtisë dhe Industrisë, ankesa e ankuesit Ramadan Buzhalës ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor.

Komisioni për zgjedhjen kontesteve dhe ankesave i Ministrisë së Tregëtisë dhe Industrisë, me rastin e shqyrtimit të ankesës së Ramadan Buzhalës, duhet me i arsyetue shkeljet e supozuara me faktet dhe provat dhe te nxjerr vendim meritor dhe te drejtë, duke vërtetuar se a janë shkeljet disiplinore të argumentuara nga ana e Komisionit Disiplinor.

Duke u bazuar në faktet dhe provat e cekura më lartë, pa u lëshuar në përmbledhjen e veprimeve të tjera, Kolegji i Këshillit ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pa kënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit 30 (tridhjetë) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i Konfliktit Administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA E KOSOVËS	
MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIËS	
Numri i Dokumentit: 1001	Numri i Aktit: 367
Shifri i Klasifikimit: -02-	Data e Miratimit: 03.02.12

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry
Komisioni i Ankesave - Komisija za Žalbe - Commission of Clamour

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në mbështetje të nenit 136 paragrafi 1 nënparagrafi a) të Ligjit Nr.02/L-28 Për Procedurën Administrative, nenit 82 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 9 paragrafi 7 të Rregullores Nr.05/2011 Për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, shqyrtoi Ankesën Nr.14 të datës 04.01.2012 të Ramadan Buzhala, kundër Vendimit Nr.698 të datës 09.12.2011 të Komisionit disiplinor, në seancën dëgjimore të mbajtur me datën 18. Janar 2012, dhe takimin e serishëm me datën 27 Janar 2012, morri këtë:

V E N D I M

1. HIDHET POSHTË Ankesa Nr.14 të datës 04.01.2012 e z. Ramadan Buzhala kundër Vendimit Nr.698 të datës 09.12.2011 të Komisionit disiplinor, si e pabazë.
2. VËRTETOHET Vendimi Nr. 698 të datës 09.12.2011, i nxjerrur nga Komisioni disiplinor si i bazuar.

A r s y e t i m

Komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave shqyrtoj Ankesën Nr.14 të datës 04.01.2012 e Ramadan Buzhala kundër Vendimit Nr.698 të datës 09.12.2011 të Komisionit disiplinor në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe të gjitha provat veç e veç, vërtetohet se Vendimi i komisionit disiplinor është i bazuar për Ndërprerjen e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil dhe refuzoj Ankesën si të pa bazë të palës ankuese.

Nga kjo u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

UDHËZIM JURIDIK: Kundër vendimi të Komisionit pala e pa kënaqur ka të drejtë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, brenda afatit prej 30 ditëve prej datës së pranimit të vendimit me shkrim drejtpërdrejt apo me anë të postës-urgjent.

Anëtarët e Komisionit të Ankesave

1. Hafiz Gara / Kryesues
2. Nexhmije Shala / Anëtare
3. Fadil Mustafa / Anëtarë







Vendimi i dorëzohet:

- Ramadan Buzhala;
- Sekretares së Përgjithshme të MTI-së;
- DAQ-re/ Divizionit të Personelit;
- Komisionit të Ankesave dhe
- Arkivës në MTI-jë.



KOM

1627

3

20.04.12

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry
Komisioni i Ankesave - Komisija za Žalbe - Commission of Clamour

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në mbështetje të nenit 136 paragrafi 1 nënparagrafi a) të Ligjit Nr.02/L-28 Për Procedurën Administrative, nenit 82 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 9 paragrafi 7 të Rregullores Nr.05/2011 Për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, Vendimit A 02/37/2012 datë 05.04.2012 Të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shqyrtoi Ankesën Nr.14 të datës 04.01.2012 të Ramadan Buzhala, kundër Vendimit Nr.698 të datës 09.12.2011 të Komisionit disiplinor, në seancën e mbajtur me datën 20.04.2012, morri këtë:

V E N D I M

1. REFUZOHET SI E PABAZUAR Ankesa Nr.14 të datës 04.01.2012 e z. Ramadan Buzhala kundër Vendimit Nr.698 të datës 09.12.2011 të Komisionit disiplinor.
2. VËRTETOHET Vendimi Nr. 698 të datës 09.12.2011, i nxjerrur nga Komisioni disiplinor si i bazuar.

A r s y e t i m

Komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave pas marrjes së Vendimit A 02/37/2012 datë 05.04.2012 Të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rishqyrtoj ankesën Nr.14 të datës 04.01.2012 të z. Ramadan Buzhala kundër Vendimit Nr.698 të datës 09.12.2011 të Komisionit disiplinor në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe të gjitha shkresat lidhur me lëndën e lartpërmendur dhe VËRTETOJ se Vendimi i komisionit disiplinor është i bazuar për Ndërprerjen e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil dhe refuzoj Ankesën si të pa bazë të palës ankuese.

Për shkak se :

- Z.Ramadan Buzhala ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.2004/05 Për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës dhe me Ligjin nr.03/L-138 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit

nr.2004/05 Për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës, Për lëshimin e lejeve të importit, ku në asnjë dispozitë ligjore nuk ceket fjala leje importi, derisa neni 5 paragrafi 2 të Ligjit nr.03/L-138 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/05 thotë se: Zyra e Licencimit do të shqyrtojë dhe marrë vendim për pajisjen me licencë për veprimtari në sektorin e tregtimit dhe përpunimit të naftës dhe derivateve të naftës. Lëshimi i lejeve është bërë pa bazë ligjore (bashkangjitur keni një kopje të lejes së importit)

- Z. Buzhala ka lëshuar vendime dhe u janë dërguar palëve në të cilat palët kanë ushtruar veprimtarinë me vendime (sipas procesverbalit nr.697 datë 09.12.2011 faqe 5 pika 3 e parafundit të faqes, dhënë nga Z. Buzhala). Këto vendime janë lëshuar pa miratimin e Ministres dhe janë në kundërshtim me Ligjin nr.03/L-138 "Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/05 Për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës" neni 5 paragrafi 4.7 ku thuhet se: 4.7 Ministri ka të drejtë që në rast se vlerëson se nuk janë zbatuar procedurat ligjore, lidhur me marrjen e çdo vendimi të Zyrës së Licencimit, mund të pezullojë atë vendim dhe së bashku me gjithë lëndën t'ia kthejë Zyrës së Licencimit,, në rishqyrtim. Kjo nënkupton se z. Buzhala ka bërë shkelje të dispozitave ligjore ku këto vendime nuk i ka përcjellur te Ministrja për shqyrtim dhe miratim por ka vendos që drejtpërdrejtë t'ia dërgoi palës.
- Sipas procesverbalit nr.697 datë 09.12.2011 faqe 6 pika 6 e parafundit të faqes, z. Buzhala ka deklaruar se vendimet janë protokolluar me protokoll intern, gjë që vendimet kanë dalë nga zyra për licencimin e naftës pa protokoll.(bashkangjitur keni vendimin e lëshuar nga z. Buzhala).
- Sipas procesverbalit nr.697 datë 09.12.2011 faqe e fundit të faqes, z. Buzhala ka deklaruar se lejet e importit janë lëshuar për import të vajrave, gjë që nga komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave është vërtetuar se leje importi ka lëshuar edhe për bombola gazi (bashkangjitur keni lejen e importi lëshuar nga z. Buzhala).
- Z. Buzhala ka lejuar shkeljen e akteve ligjore dhe nënligjore nga zyrtarët e tij, siq shihet me deklaratën e dhënë nga zyrtarja e tij znj. Valdete Halimaj në procesverbalin nr.697 datë 09.12.2011 faqe 3 pika 6 e parafundit të faqes ku thotë se "U.A.Nr. 07/2010 e parasheh që Zyra e licencimit mundet që në bashkëpunim me inspektoratin e tregut të ushtrroj kontrolli te subjektet e licencuara, por pasi kjo nuk ka qenë e mundur ne kemi dal ne teren dhe kemi vizituar subjektet pa inspektoratin". Udhëzimi e parasheh bashkëpunimin me inspektoratin, mirëpo nuk ju lejon që zyra e licencimit të dal ne teren për ti vizituar subjektet pa inspektoratin.
- Ankuesi z.Ramadan Buzhala jo vetëm që nuk ka pasur të drejtë të lëshoj leje importi por në kohën kur ka udhëtuar për në Beograd z.Buzhala ka deklaruar se ka autorizuar znj. Valdete Halimaj që të zëvendësojë, gjë që nuk ekziston asnjë autorizim zyrtar me shkruar. Mirëpo vetëm me telefon e ka autorizuar që të lëshojë leje importi (sipas procesverbalit nr.697 datë 09.12.2011 faqe 3 pika 4 e parafundit të faqes, dhënë nga znj. Valdete Halimaj).

Sa i përket ankesës Nr.14 të dates 04.01.2012 të arsyetimit të z.Ramadan Buzhala për shkelje esenciale të procedurës refuzohet si e pabazë për arsye se:

- Neni 5 të Rregullores Nr.05/2011 Për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, parasheh që Komisioni i Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave themelohet në kuadër të çdo institucioni qendror dhe komunal ku janë të punësuar nëpunësit civil në këtë komision duhet të përfshihet diversiteti gjinor dhe një anëtar të zgjidhet ku ka njohuri për fushën ku është bërë shkelja. Në këtë rast anëtarja e tretë të komisionit ad hoc i ka të drejtat e barabarta në vendim marrje sikur se anëtarët e tjerë të komisionit.
- Procesverbali i mbajtur në seancën e komisionit disiplinor për hir të transparencës është mbajtur edhe me diktafon (këtë mund ta kërkon ankuesi nëse dyshon në procesverbal).

Në konstatimin jo të plotë të gjendjes faktike:

Ankesa e z. Buzhala hidhet poshtë sepse Sekretarja e përgjithshme e MTI-së vendimin për pezullimin, e ka marrë konform nenit 63 paragrafi 1 të Ligjit 03/L-149 "Për shërbimin civil të Republikës së Kosovës", ku thuhet se : *"Nëpunësit civilë do t'u nënshtrohen masave disiplinore për shkelje të detyrës, që ka ndodhur si rezultat i fajit të tyre, sikur që është përcaktuar me këtë ligj"* dhe nenit 65 të këtij ligji ku citohet se : *1. Nëpunësit civilë janë përgjegjës për të gjitha dëmet e shkaktuara qytetarëve ose institucionit gjatë ushtrimit të detyrës si rezultat i paaftësisë profesionale, neglizhencës së rëndë ose veprimeve të qëllimshme, të paligjshme. 2. Pas përcaktimit të përgjegjësisë, do të bëhet sanksionimi i nëpunësit civil, i cili i ka shkaktuar dëm institucionit ose qytetarëve.*

Vendimi për pezullimin nga Sekretarja e përgjithshme e MTI-së si organi më i lartë i shërbyesve civil, është marrë me qëllim që të mos të vazhdohet me shkelje derisa rasti i z. Buzhala të procedohet në komisionin disiplinor konform procedurave ligjore në fuqi.

Nga kjo u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

UDHËZIM JURIDIK: Kundër vendimi të Komisionit pala e pa kënaqur ka të drejtë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, brenda afatit prej 30 ditëve prej datës së pranimit të vendimit me shkrim drejtpërdrejt apo me anë të postës-urgjent.

Anëtarët e Komisionit të Ankesave

1. Hafiz Gara / Kryesues
2. Nexhmije Shala / Anëtare
3. Selviqe Qekaj / Anëtare

Vendimi i dorëzohet:

- Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës;
- Ramadan Buzhala;
- Sekretares së Përgjithshme të MTI-së;
- DAQ-re/ Divizionit të Personelit;
- Komisionit të Ankesave dhe
- Arkivës në MTI-së.